



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 282/2 prot.,

Datë 13.02.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “HTSH” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-54604-12-21-2022, me objekt: “Rrethim dekorativ i stadiumit të lojrave me dorë”, me fond limit 3,335,385 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tropojë.

**Ankimues:** “HTSH” SHPK  
*Adresa: L. “Partizani”, Rr. “Fatmir Hasandoci”, Zona Kadastrale 1347, Nr pasurie 11/60, Tropojë*

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tropojë  
*Adresa: Tropojë*

Në datën 10.02.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 282 prot., e operatorit ekonomik “HTSH” SHPK për procedurën e prokurimit prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-54604-12-21-2022, me objekt: “Rrethim dekorativ i stadiumit të lojrave me dorë”, me fond limit 3,335,385 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tropojë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “HTSH” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

*b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; ”.*

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “HTSH” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 282 prot., datë 10.02.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

**Arsyet e skualifikimit:**

*Në lidhje me kapacitetin teknik, pika 1 e tij "Përvojat e mëparshme rezulton se operatori ekonomik nuk i ploteson asnjërën nga kriteret pasi rezulton se operatori ekonomik ka ngarkuar si dëshmi për përvojat e mëparshme dokumente (formulare vlersimi dhe kontrate punimesh) me korrigjime, si dhe për një përvoje tjetër pune ka paraqitur 1 kontrate në gjuhë të huaj e të pa përkthyer në gjuhën Shqipe.*

*Ndërsa në lidhje me kriteret e vecanta të kualifikimit, "sigurimi i ofertes sipas shtojces 3", operatori Ekonomik ka sjellë një sigurim oferte jo sipas formatit të parashikuar në shtojcën numër 3.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 13.02.2023.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**